



**Qendra për Këshillim në Karrierë  
Komuna e Prishtinës**

**Komuna e Prishtinës, në kuadër të Projektit “Themelimi i Qendrës së Karrierës dhe Qendrës së Biznesit” të financuar nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar shpall:**

**KONKURS**

**Për angazhimin e një konsulenti për organizim të trajnimeve për stafin e Qendrës për Këshillim në Karrierë.**

**Temat e trajnimit:**

1. Trajnim për Trajner (ToT) në Ndërmarrësi dhe Menaxhim Biznesi (10 Ditë) i cili mund të lëshoj certifikatë ndërkombëtare për ToT
2. Ndërtimi ekipit - puna efektive në ekip (3 ditë)
3. Shkathhtësitë në shitje (3 ditë)
4. Metodologjia e Internshipit (3 ditë).

**Kriteret**

1. Përvoja e konsulentit/es duhet të jetë minimumi 3 vjet në trajnime për stafin e qendrave të karrierës;
2. Duhet të ketë certifikatë nga ndonjë institucion ndërkombëtar në temat përmendura më poshtë;
3. Personat juridik dhe fizik të cilët aplikojnë duhet të sjellin tre(3) referenca që dëshmojnë realizimin e punëve të ngjashme.

Pjesëmarrja në këtë konkurs është e hapur për të gjithë personat fizik dhe juridik, të cilët kanë përvojë pune në trajnimin e stafit të Qendrave të karrierës.

Pyetjet dhe informatata e tjera të cilat kanë të bëjnë me konkursin mund të dërgohen në email adresën [merita.mustafa@rks-gov.net](mailto:merita.mustafa@rks-gov.net) deri me datën 26.02.2016, ora 16:00.

Aplikimi duhet të bëhet më së largu me 29.02.2016, ora 16:00, në email adresën [merita.mustafa@rks-gov.net](mailto:merita.mustafa@rks-gov.net)

Pas skadimit të afatit të konkursit, ofertat nuk do të merren parasysh.

**Adresa:**

Komuna e Prishtinës

Rr. UÇK Nr. 2, Prishtinë, Kosovë

Tel: 038 230 900

**Qendra për Këshillim në Karrierë, Komuna e Prishtinës**

Qendrën për Këshillim në Karrierë funksionon në kuadër të Komunës së Prishtinës dhe krijon parakushtet për lidhjen e shkollave Arsimit dhe Aftësimi Profesional (AAP) me sektorin privat, dhe që do të kontribuon tek studentët e shkollave AAP në ndërtimin e efektshmërisë ndërpersonale, rritjen e mundësive për karrierë, përmirësimin e tregtueshmërisë së punësimit, promovimin e gjetjes efektive të vendit të punës dhe përforcimin e marrëdhënjëve më punëdhënësin.

**Roli i Qendrës për Këshillim në Karrierë**

Qendra për Këshillim në Karrierë e Komunës së Prishtinës do të luaj një rol vendimtar në përforcimin e lidhjeve në mes të sektorit privat dhe shkollave Arsimi dhe Aftësimi Profesional. Qendra do t'u ofrojë nxënësve të shkollave AAP mundësitë për të fituar njohuri, aftësi, përvojën e duhur për të identifikuar opcionet; për të shqyrtuar alternativat në tregun e punës dhe për të patur sukses në shoqëri.